L I G J
Nr. 8591, datë 28.3.2000

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.7665, DATË 21.1.1993 "PËR ZHVILLIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI TURIZMIN", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8163, DATË 7.11.1996 DHE LIGJIN NR.8368, DATË 9.7.1998

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", ndryshuar me ligjin nr.8163, datë 7.11.1996 dhe nr.8368, datë 9.7.1998 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

"Shtyhet deri më 31.12.2001 koha e përfitimit të së drejtës për përjashtimet doganore, vetëm për qëllimin e kryerjes së investimit për investitorët që gëzojnë titullin "person i stimuluar" dhe përpara datës 7.11.1996 kanë lidhur marrëveshje zhvillimi në bazë të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin". Kjo shtyrje afati përcaktohet varësisht nga koha e humbur e këtyre përfitimeve, deri më datë 28.3.2000."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2590, datë 5.4.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.